Përforcimi i Kapaciteteve Edukuese dhe Trajnuese për Ruajtjen e Burimeve Natyrore në Basenet e Ohrit-Prespës

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar (IPA Shqipëri-Maqedoni)
Prill 2012 – Shtator 2013

SITUATA E PËRGJITHSHME NË RAJONIN NDËRKUFITAR TË BASENEVE TË LIQENIT TË OHRIT DHE TË PRESPËS

(ANALIZA SWOT)

Partnerët:

1. ***Research Centre for Rural Development (RCRD), Albania***
2. ***The Union of the Ecologists "Natyra", Macedonia***
3. ***"Krste Jon", Macedonia***
4. ***Programi Kombëtar i Qendrave Rinore (SOEK), Albania***
5. ***"Kadmi & Harmonia" , Albania***

Përgatitur nga: KOCKA Training Institute

Financuar nga Bashkimi Europian

Ky dokument është përgatitur nga:

KOCKA Training Institute,

Në kuadër të projektit:

"Përforcimi i Capaciteteve Edukuese dhe Trajnuese për Ruajtjen e Burimeve Natyrore në Basenet e Ohrit-Prespës"

Kontratë Numër: 2012/288-302

Mars 2013



Financuar nga Bashkimi Europian

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E DOKUMENTIT 1

INFORMACION BAZË 2

OBJEKTIVAT DHE QËLLIMET E KËTIJ DOKUMENTI 6

OBJEKTIVAT E PROJEKTIT 7

METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR PËRGATITJEN E ANALIZËS SWOT 8

PREZANTIM I ANALIZËS SWOT 9

PARAQITJE E SITUATËS AKTUALE 10

MATRIKSI SWOT 11

KORNIZA LIGJORE PËR ZONAT E MBROJTURA 13

SITUATA SOCIALE DHE EKONOMIKE 15

VLERËSIMI I SITUATËS MJEDISORE 20

VLERËSIMI I KAPACITETEVE DHE NEVOJËS PËR EDUKIM MJEDISOR 24

REKOMANDIME 27



Përmbledhje e shkurtër e dokumentit

Ky dokument është realizuar në kuadër të projektit "Përforcimi i Kapaciteteve Edukuese dhe Trajnuese për Ruajtjen e Burimeve Natyrore në Basenet e Ohrit-Prespës" i cili bën pjesë në Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar (IPA Albania-Macedonia) i implementuar në periudhën prill 2012 – shtator 2013.

Qëllimi i këtij dokumenti është realizimi i analizës dhe krijimi i një Matrice të Bashkëpunimit-Mundësive në nivel rajonal dhe identifikimi i praktikave të mira dhe nevojave të bashkive dhe njësive të qeverisjes lokale si dhe përshkrimi i përparimeve aty ku është implementuar projekti.

Dokumenti përbëhet nga tre pjesë kryesore:

- Informacioni bazë – që shpjegon situatën e përgjithshme në rajon dhe nevojën për një analizë të planifikuar për planifikimin dhe zhvillimin e ardhshëm të zonës ndër-kufitare. Kjo pjesë përfshin gjithashtu metodologjinë e përdorur për zhvillimin e dokumentit, përfshi grupet e synuara dhe përfituesit të cilët kanë një rëndësi thelbësore për analizën e mirë të cilësisë dhe për dokumentin;
- Analiza e detajuar e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe trajtimeve në zona të përcatuara të basenit të Ohrit-Prespës, Korniza ligjore për zonat e mbrojtura, Situata ekonomike dhe sociale, Situata mjedisore dhe Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave për edukim mjedisor. Secila prej këtyre temave është përpunuar veçmas me një analizë përmbledhëse të situatës dhe konkluzionet;
- Rekomandimet e përgithshme rreth analizës së rajonit për të gjitha temat dhe fushat.

Ky dokument mund të përdoret nga të gjitha grupet e interesit në rajon, përfshi njësitë e qeversjes vendore, institucionet publike, biznesi dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, edukim dhe menaxhimin e turizmit.



Informacion bazë

Pothuajse gjysma e kufirit ndërkombëtar midis Shqipërisë dhe Maqedonisë (65 km) ndan basenet e Liqeneve të Prespës së Vogël, Prespës së Madhe e Liqenit të Ohrit. Ky rajon ka një rëndësi të veçantë për të dyja vendet; kjo është zona me zhvillim ekonomik më të madh përgjatë kufirit, një nga zonat më të pasura ekologjikisht në Ballkan dhe në të njëjtën kohë një nga zonat më të ndjeshme nga pikëpamja mjedisore.

Ekziston një ndryshim i konsiderueshëm midis dy vendeve, si në planin ekonomik, ashtu edhe në atë mjedisor. Në anën shqiptare, peisazhi është i degraduar, zhvillimi ekonomik është më i dobët, numri i turistëve është rreth një e katërta e numrit të turistëve të anës maqedonase, cilësia e shërbimeve është më e ulët dhe menaxhimi mjedisor është në fillimet e veta. Në ndryshim nga kjo situatë, në anën maqedonase, mjedisi është i menaxhuar më mirë dhe zhvillimi ekonomik e veçanërisht cilësia e shërbimeve turistike është më e qëndrueshme. Fakti që këmbimi i eksperiencës në fushën mjedisore, zhvillimin e qëndrueshëm, menaxhimin mjedisor nga ana maqedonase në anën shqiptare mungon ose është shumë i kufizuar është një paradoks. Gjithsesi, nuk duhet të neglizhojmë që "historia" e zhvillimit ekonomik në të dyja vendet është e ndryshme; në pesëdhjetë vitet e fundit, Maqedonia ka pasur një dinamikë zhvillimi më të lartë; një zhvillim më të harmonizuar të burimeve natyrore dhe një aplikim më korrekt të legjislacionit të mbrojtjes mjedisore.

Analizat e viteve të fundit tregojnë që diferencat në zhvillimin ekonomik midis dy vendeve janë reduktuar si pasojë e rritjes së konvergimit të politikave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit mjedisor në bazë të procesit të integrimit në BE. Kështu, pavarësisht ndryshimeve të sipërpërmendura, nevojat për ndërtimin e kapaciteteve trajnuese mbi edukimin mjedisor janë pothuajse të ngjashme. Gjithsesi, është e qartë nevoja për transferimin racional të praktikave të mira rreth menaxhimit të mjedisit nga ana maqedonase në atë shqiptare, si dhe rritja e përpjekjeve të të dy vendeve për transferimin e njohurive përkatëse mbi zhvillimin e qëndrueshëm të aplikuara në vendet anëtare të konsoliduara të BE-së.

Në kontekstin e qëndrueshmërisë të Maqedonisë dhe Shqipërisë, reformat institucionale për menaxhimin e burimeve natyrore janë çështje të rëndësishme për politikat mjedisore dhe ekonomike. Pavarësisht se reformat institucionale janë në faza të ndryshme, rrethet, bashkitë dhe drejtoritë e rretheve dhe OJQ-të në të dyja anët e kufirit kanë shprehur nevojën për të rritur njohuritë bazë dhe përmirësuar performancën e menaxhimit të burimeve

natyrore, edhe në lidhje me përafrimin me Bashkimin Europian. Një problem madhor në edukimin mjedisor ka qenë mungesa e bashkëpunimit midis qendrave me kualifikim të lartë në edukimin mjedisor dhe institucioneve të tjera qendrore dhe vendore, menaxherëve të bisnesit dhe qytetarëve. Sipas Agenda 21, një nga objektivat më të rëndësishëm për të promovuar trajnimin në edukimin mjedisor është: *"Përforcimi i kapaciteteve kombëtare, veçanërisht në edukimin shkencor dhe trajnim, për të bërë të mundur që Qeveritë, punëdhënësit dhe punonjësit të arrijnë objektivat mjedisorë dhe të lehtësojnë transferimin dhe asimilimin e teknologjive të përshtatshme dhe shoqërisht të pranueshme e që respektojnë mjedisin dhe të dijnë-se-si"* (Kapitulli 36 Agenda 21)

Projekti Build Traca është implementuar në Liqenin e Ohrit dhe Liqenet e Prespës, një rajon me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, veçanërisht atë turistik, në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, për të dy vendet. Për Maqedoninë, basenet e Ohrit dhe të Prespës përbëjnë zonën turistike më të rëndësishme e cila ofron mirëqënie për banorët e brigjeve të liqenit. Për Shqipërinë, rajoni është një pikë reference për zhvillimin e qëndrueshëm për të siguruar shmangien e degradimit të mëtejshëm të ekosistemit si pasojë e mbipopullimit, keqpërdorimit të hapësirës dhe presionit mbi burimet natyrore nga popullata rurale. Për të dy vendet, rajoni përbën një reservë të madhe të zhvillimit turistik të qëndrueshëm për shkak të pranisë së burimeve natyrore të bollshme dhe të veçanta, parqeve të mbrojtura me mundësi të madhe për aktivitete të kohës së lirë, zhvillimit të shpejtë të infrastrukturës, politikave të ngjashme për menaxhimin e mjedisit dhe popullsisë multietnike. Kështu, ky rajon vlerësohet si një pikë-takimi kulturore me efekte energjitike pozitive nëse ambiciet kanë të njëjtin qëllim.

Gjatësia e vijës kufitare që kalon në rajon është rreth 65 km dhe kalon përmes baseneve të Liqenit të Prespës së Vogël (lindje) dhe Liqenit të Prespës së Madhe (perëndim). Këtu ndodhet Parku Kombëtar i Prespës (27500 ha) i cili bën pjesë në tre shtete: Shqipëri – Maqedoni – Greqi dhe përfshin Liqenet e Prespës së Madhe dhe të Prespës së Vogël. Në anën e Maqedonisë ndodhet Parku i Galicicës (25000 ha), me 176 specie bimësh, prej të cilave 58.4% janë indigjene. Ai është një nga tre parqet më të mëdha të Maqedonisë. Në faqen lindore të Malit të Shebenikut (në kufi me Shqipërinë) ndodhet një Zonë Rreptësisht e Mbrojtur. Në anën e Shqipërisë, përveç Parkut Kombëtar të Prespës (më i madhi në Shqipëri), një sipërfaqe prej 5063 ha e lokalizuar në anë të Liqenit të Ohrit është shpallur Zonë Rreptësisht e Mbrojtur (në 1996 dhe 2006) dhe në faqen perëndimore të Malit të Shebenikut, pyjet e Rajcës përbëjnë Parkun Kombëtar të Rajcës (4700 ha). E gjithë zona midis këtyre dy

vendeve në Liqenin e Ohrit dhe Prespës është shpallur zonë e mbrojtur ose park kombëtar (rreth 60 000 ha).

Në planin demografik, burimet njerëzore dhe situata socio-ekonomike e rajonit ku do të implementohet projekti, është si vijon; në anën e Shqipërisë: popullsia 261 000; 57% merren me bujqësi; janë dy ekipe me 60 anëtarë që merren me menaxhimin e parqeve kombëtare, 1300 biznese të vogla, 38 hotele me një kapacitet prej 370 shtretërish, 34 OJQ-lokale me përvojë në studime/aktivitete në fushën mjedisore, 164 peshkatarë të liçensuar, 18 shkolla të mesme dhe rreth 11400 nxënës, 630 mësues (54 mësues biologjie dhe 76 mësues gjeografie), 14 departamente bujqësie (4 drejtori pyjore, 2 drejtori mjedisore, 4 drejtori arsimore) me rreth 230 punonjës dhe një Universitet me 3000 studentë (F. Noli, Korçë).

Në anën Maqedonase, situata është si vijon: popullsia 101 800, 28% prej të cilëve merren me bujqësi, ekzistojnë dy ekipe për menaxhimin e parqeve kombëtare me 56 punonjës, 84 hotele me rreth 2900 shtretër, pesë shkolla të mesme me rreth 4800 nxënës, 108 OJQ me rreth 430 anëtarë, departamente lokale të bujqësisë dhe një degë e Universitetit të Tetovës (Fakulteti i Ekologjisë me 300 studentë).

Ka një mungesë bashkëpunimi midis korpusit profesional dhe institucioneve qeveritare/civile nga njëra anë dhe nga ana tjetër, një mungesë koordinimi midis qeverisjes lokale dhe qeverisë qendrore, si dhe mungesë të financimeve të rëndësishme. Këto mungesa bëjnë të pamundur një koordinim të qartë në nivel kombëtar/vendor për edukimin mjedisor.

Sipas Progamit Rajonal të BE-së (Ballkani Perëndimor 2006-2011: tendencat, mundësitë dhe rreziqet) problemet për të dy vendet janë si më poshtë:

Qeverisje mjedisore e dobët: Kapacitetet institucionale dhe administrative të qeverisjes qendrore dhe lokale në vendet e Ballkanit Perëndimor janë disi të dobëta. Parimet e përgjithshme të pranuara të menaxhimit të mjedisit si "ndotësi paguan", "parimi i parandalimit" dhe "qasja ndaj ekosistemit" nuk vihen në zbatim.

Integrimi në Europë është një stimul i fortë për menaxhimin mjedisor: Perspektiva e hyrjes në BE është një stimul kyç për përmirësimin mjedisor në rajon. Nëpërmjet përmbushjes së detyrimeve të Procesit të Vendeve Kandidate, Vendet e Ballkanit Perëndimor po lëvizin drejt implementimit të legjislacionit mjedisor të BE.

Mungesa e burimeve financiare për investimet mjedisore: Përafrimi me vendet e BE-së kërkon investime të mëdha në infrastrukturën mjedisore. Studime të Komisionit Europian kanë llogaritur që përputhja e plotë e legjislacionit të Vendeve të Europës Lindore me legjislacionin e BE-së do të

kërkojë shpenzimin e dy deri tre përqind të PBB (Prodhimit të Brendshëm Bruto) çdo vit. Në të dy vendet, ku PBB është ende shumë i ulët, arritja e këtij niveli shpenzimesh paraqet një problem madhor.

Bashkëpunimi i kufizuar ndërkufitar: Megjithëse shumë probleme mjedisore në Ballkanin Perëndimor kanë efekte ndërkufitare, bashkëpunimi midis vendeve fqinje nuk është i shpeshtë.

Në bazë të analizës së realizuar në këtë rajon kufitar, është vënë re që ky rajon ka një rëndësi të madhe ekonomike dhe mjedisore. Megjithëse ekzistojnë shumë mundësi për një klimë ekonomike pozitive dhe bashkëpunimi midis palëve shqiptare dhe maqedonase, për arsyeve të ndryshme, këto mundësi nuk shfrytëzohen mjaftueshëm. Një nga arsyet është mungesa e funksionimit të fluksit të informacionit si një bazë e mirë për bashkëpunimin e shpeshtë të palëve të interesuara në rajon. Për më tepër, ekzistojnë disa pengesa ligjore dhe infrastrukturore, probleme dhe vështirësi, të cilat po pengojnë ose ngadalësojnë bashkëpunimin e mundshëm. Nuk është realizuar asnjë aktivitet konkret dhe serioz për të rritur dhe përmirësuar situatën në këtë fushë. Si një bazë e fortë për të përforcimin e mëtejshëm të bashkëpunimt midis dy vendeve mund të shërbejnë autoritetet lokale të qyteteve në zonën kufitare.

Objektivat dhe qëllimet e këtij dokumenti

QëllimiiRezultate2tëprojektitështëkrijimiinjëMatriceBashkëpunimi/Mundësish në nivel dy-kombësh/rajonal nëpërmjet identifikimit, analizës dhe përcaktimit të etapave të axhendave të bashkëpunimit të administratë së qeverisjes lokale dhe OJQ-ve.

Objektivat specifike të kësaj pakete pune janë:

- Të mbledhë, analizojë dhe vlerësojë politikat/programet/veprimet ekzistuese, axhendat dhe infrastrukturën nga pikëpamja konceptuale dhe e edukimit mjedisor.
- Të identifikojë praktikat e mira dhe nevojat e administratës lokale dhe përshkruajë përparimet e arritura.
- Të identifikojë pikat e forta dhe dobëta, mundësitë dhe kërcënimet (SWOT) në katër nën-rajone (Ohër dhe Strugë, Pogradec dhe Prespë) në basenet e liqeneve të rajonit.
- Të realizojë, në bashkëpunim me aktorë të tjerë në rajon, studimet e mëposhtme: (i) kushtet mjedisore dhe problemet më të rëndësishme dhe përcaktimin e përparësisë mes tyre, (ii) situatën e pyjeve dhe menaxhimin e zjarreve, (iii) zhvillimin bujqësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm, (iv) perspektivën afatshkurtër dhe afatgjatë të zhvillimit të turizmit dhe pengesat/avantazhet.
- Të identifikojë sinergjitë dhe përputhshmëritë midis partnerëve.



Objektivat e Projektit

Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i performancës profesionale në edukimin mjedisor që kontribuon në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të zonës ndërkufitare të rajonit jug-perëndimor të Maqedonisë (Bashkitë e Ohrit dhe Strugës) dhe Qarqet e Korçës dhe Elbasanit në Shqipëri (Rrethet e Pogradecit dhe Librazhdit).

Objektivat specifike të projektit janë:

1. Përmirësimi i kapaciteteve të edukimit mjedisor nëpërmjet rritjes së nivelit të kompetencës në të dy anët e kufirit;
2. Inkurajimi i transferimit të njohurive nëpërmjet krijimit të rrjeteve midis autoritetete të qeverisjes lokale, profesorëve universitarë, institucioneve trajnuese dhe OJQ-ve, dhe
3. Promovimi i aktiviteteve të përbashkëta.

Rezultatet e pritshme të aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të projektit duhet të jenë:

- Mbrojtja e mjedisit biotik
- Eliminimi i peshkimit të tepruar
- Mbrojtja e specieve të rralla
- Përmirësimi i kushteve të menaxhimit në zonat e mbrojtura
- Kontrolli i nivelit të liqenit
- Kontrolli i ndotjes së ujit
- Kontrolli i ndotjeve industriale
- Krijimi i sistemeve të përbashkëta të monitorimit
- Kontrolli i aktivitetit bujqësor
- Reduktimi i përdorimit të tepruar të fertilizantëve
- Krijimi i mundësive për zhvillimin e turizmit
- Ulja e papunësisë
- Përmirësimi i infrastrukturës

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e analizës SWOT

Metodologjia e përdorur për zhvillimin e analizës SWOT u bazua në metodat dhe teknikat me pjesëmarrje të lartë. Nëpërmjet proceseve pjesëmarrëse të konsultimeve që kishin si synim të gjitha palët e interesuara, përfshi studimet dhe analizën e dokumentave strategjikë bashkiakë, strategjive rajonale, strategjive dhe politikave kombëtare dhe gjithashtu duke përfshirë konsultimet me shoqërinë civile.

Aktivitetet u përqëndruan në këto grupe të synuara:

- Autoritetet lokale (komunat, bashkitë, rrethet dhe prefekturat)
- Njësitë e administrimit të territorit të Bashkive të Strugës, Ohrit, Pogradecit dhe Librazhdit
- Agjensitë mjedisore, Drejtoritë e Pyjeve, Drejtoritë e Bujqësisë dhe Drejtoritë Arsimore, Njësitë e Parqeve dhe Turizmit në rajon
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (ana shqiptare) dhe Ministria e Qeverisjes Lokale (ana maqedonase)
- Ministria e Bujqësisë, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (ana shqiptare) dhe Ministria e Bujqësisë (ana maqedonase)
- Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
- Shoqatat mjedisore, bujqësore, të pyjeve dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit
- Mësuesit dhe nxënësit e shkollave të mesme të rajonit
- Organizatat kombëtare/lokale të Shoqërisë Civile (të përfshira në edukimin mjedisor dhe zhvillimin e qëndrueshëm)

Procesi ishte gjithashtu i hapur për:

- Popullsinë e rajonit të Ohrit dhe Prespës
- Industrinë turistike të rajonit
- Autoritetet lokale të terrorit në të dyja anët e kufirit, të cilat përfitojnë nga modeli i menaxhimit të burimeve natyrore (pyjet dhe kullotat), zhvillimi i qëndrueshëm, edukimi mjedisor dhe marrëveshjet institucionale ligjore.



Prezantim i analizës SWOT

Matrica SWOT është një mjet analitik modern në planifikimin strukturor që mund të shërbejë për të vlerësuar Pikat e forta (**S**trength), Pikat e dobëta (**W**eakness), Mundësitë (**O**pportunities) dhe Kërcënimet (**T**hreats) të situatës aktuale në fusha specifike. Ajo ndihmon në identifikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që janë të favorshëm dhe të pavaforshëm për arritjen e objektivave specifikë. Në përgjithësi është një mjet që jep një tablo të qartë të situatës aktuale dhe ndihmon në planifikimin e mëtejshëm të aktiviteteve në mënyrë që të arrihet një objektiv specifik.

Më saktësisht, elemetë e analizës SWOT përfshijnë:

- **P**ikat e forta: karakteristikat që ofrojnë avantazhe në krahasim me të tjerat
- **P**ikat e dobëta: karakteristikat që kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm
- **M**undësitë: elementët që mund të përdoren si avantazh
- **K**ëcënimet: elementët e jashtëm që mund të kërcënojnë situatën aktuale

Qëllimi i çdo analize SWOT është identifikimi i faktorëve kyç të jashtëm dhe të brendshëm që janë të rëndësishëm për arritjen e objektivave. Analiza SWOT grupon pjesët kryesore të informacionit në dy kategori kryesore:

- Faktorët e brendshëm – Pikat e forta dhe të dobëta të brendshme të organizatës dhe/ose rajonit
- Faktorët e jashtëm – Mundësitë dhe kërcënimet që vijnë nga mjedisi i jashtëm i organizatës ose fushës së punës.

Në bazë të fakteve nga analiza SWOT të çiftuara me analizën e objektivave, ne identifikuam mundësitë që janë të pajtueshme me pikat e forta të basenit të Ohrit-Prespës, i përdorim ato për të tejkaluar dobësitë, përpiqemi të përdorim pikat e forta për të reduktuar ndjeshmërinë ndaj kërcënimeve të jashtme dhe të ndërtojmë një plan të përshtatshëm për të minimizuar pikat e dobëta dhe shmangur kërcënimet.

Gjatë përgatitjes së analizës SWOT ne përputhëm pikat e forta me mundësitë për të gjetur avantazhet konkuruese. Ne gjithashtu u përpoqëm të konvertonin pikat e dobëta ose kërcënimet në pika të forta ose mundësi. Në këtë mënyrë kërkuam zgjidhjet e përshtatshme.

Analiza SWOT është e rregulluar në Termat e Referencës së projektit dhe vlerëson në detaje situatën e përgjithshme në rajonin e Ohrit-Prespës për sa i përket lokalizimit, historisë gjeologjike, hidrologjisë, jetës së egër, rrethanave ekonomike dhe sociale, bazave institucionale dhe ligjore për mbrojtjen dhe zhvillimin e tij.



Paraqitje e situatës aktuale

Objektivi kryesor i projektit është jo vetëm të përmirësojë situatën mjedisore dhe të ruajë cilësinë mjedisore aktuale, por gjithashtu të përforcojë qëndrueshmërinë në lidhje me aktivitetet njerëzore dhe burimet natyrore dhe të rrisë standardin e jetesës së banorëve. Me fjalë të tjera të arrijë zhvillimin e qëndrueshëm.

Për të arritur këtë u analizuan dhe u morën në konsideratë si pikënisje për zhvillimin e mëtejshëm të këtij dokumenti problemet e ndotjes dhe uljes së vëllimit të ujit të liqenit, burimeve natyrore, mjedisit biotik dhe zhvillimit socio-ekonomik.

Trashëgimia nayrore dhe biodivesiteti unik i rajonit është nën një presion të fortë dhe të vazhdueshëm nga faktori antropogjen.

Po ndodhin gjithashtu ndryshime të cilësisë së ujit dhe ka një reduktim konstant të tërheqjes së turistëve për shkak të eutrifikimit dhe rritjes së ndotjes (mbetjet ujore dhe mbetjet e ngurta).

Edhe industria kontribuon në ndotjen e liqeneve. Megjithëse legjislacioni në fuqi mbulon trajtimin e mbjetjeve dhe mbetjeve ujore, qytetarët nuk e respektojnë atë.

Aktiviteti ekonomik kryesor për të dyja vende është bujqësia. Aktivitetet bujqësore në basen janë një burim domethënës ndotjeje për liqenet, pasi pesticidet dhe fertilizantët përfundojnë në liqen duke ndikuar në cilësinë e ujit.

Si pasojë e vaditjes intensive dhe fushave të gjera, niveli i liqeneve, veçanërisht i liqeneve të Prespës po ulet dhe tokat bujqësore shtrihen deri në breg të liqenit. Bujqësia intensive çrregullon gjithashtu bilancin e lëndëve ushqyese të tokës dhe ndikon në burimet natyrore.

Që nga viti 1960, prodhimi i peshkut është vazhdimisht në rënie për shkak të peshkimit të tepruar dhe rritjes së tepërt të shtrateve të kallameve dhe ka një ulje konstante të numrit të peshkatarëve. Në Shqipëri dhe Maqedoni vërehet gjithashtu një ulje e prodhimit të peshkut dhe një ndryshim i llojeve të peshqve dhe bentofaunës për shkak të ndotjes së ujit. Ky fakt si dhe futja e mundshme në liqen e peshqve të huaj çrregullon mjedisin biotik.

Të ardhurat totale për person janë të ulëta, ndërsa ka një rritje të papunësisë. Mungesa e mundësive i detyron njerëzit dhe veçanërisht të rinjtë të largohen nga zona për në qendra më të mëdha urbane.

Infrastruktura e cilësisë së mesme në të dy vendet e bën të ulët dhe ndonjëherë të pamundur aksesin në basen. Ky fakt si dhe niveli i papërshtatshëm i standardeve në menaxhimin e hoteleve dhe restoranteve ul interesin e turistëve për këtë rajon.



Matriksi SWOT

Përshkrimi i zonës ne basenin e Ohrit-Prespës

ÇËSHTJA	Pikat e forta janë karakteristikat që ofrojnë avantazhe	Pikat e dobëta janë karakteristikat që çojnë në disavantazhe	Mundësitë janë shance për të përmirësuar situatën	Kërcënimet janë elementë të jashtëm që mund të shkaktojnë shqetësime
Karakteristikat mjedisore dhe fizike	- Lokalizimi ideal në zonën ndërkufitare - Zonë ujëmbledhëse e gjerë - Klimë e këndshme - Tërheqëse nga pikëpamja gjeo-hidrologjike - Cilësia e ujit është ende e kënaqshme	- Rajon relativisht i izoluar nga pikëpamja infrastrukturore - Mungesë e një sistemi efiçient për mbrojtjen e ujit - Presion antropogjen i fortë	- Përmirësim i infrastrukturës - Krijim i sistemeve të mbrojtjes së ujit - Reduktim i presionit mbi mjedis nëpërmjet edukimit mjedisor	- Margjinalizim i rajonit në kontekstin turistik - "Erozion" i mëtejshëm i mjedisit rreth basenit të Ohrit-Prespës
Karakteristikat biologjike	- Habitat i shumëlloshëm si bazë për biodiversitetin - Shumë specie organizmash si atraksion - Liqeni me biodiversitetin më të lartë në botë për sipërfaqen që ka - Shumë specie endemike të pranishme	- Mungesa e kapaciteteve për mbrojtjen e biodiversitetit - Ndotja po çon disa organizma drejt zhdukjes - Habitati po ndryshon kundër rregullave të natyrës	- Masa për të mbrojtur specie në rrezik - Rritja e ndërgjegjësimit publik rreth mbrojtjes së mjedisit në rajon - Reduktimi i ndotjes në rajon	- Zhdukja e specieve të rralla - Habitate të degraduara për jetën e egër në rajon

KONKLUZIONE:

Baseni i Prespës dhe Ohrit karakterizohet nga një klimë e këndshme dhe lokalizim gjeografik tërheqës me ujë të cilësisë së mirë, ideal për iniciativat ndërkufitare në fushën e turizmit dhe përdorimin e burimeve natyrore. Nga ana tjetër, rajoni është relativisht i izoluar nga lidhjet infrastrukturore kryesore në të dy vendet, duke qenë mjaft larg nga kryeqyteti dhe nuk janë të shumta historitë e suksesit në fushën e iniciativave të përbashkëta në fushën e mbrojtjes së ujit dhe ruajtjes së burimeve.

Nga perpektiva biologjike, rajoni ka një biodiversitet të pasur, duke qenë Liqeni i Ohrit pjesë e listës së UNESCO-s të zonave të mbrojtura si Monument Kulture dhe Natyror, një nga liqenet me biodiversitet më të lartë në botë dhe gjithashtu i pasur me specie endemike.

Iniciativat e përbashkëta duhet të përqëndrohen në përmirësimin e infrastrukturës dhe shndërrimin e rajonit në një zonë me akses të lehtë, por në të njëjtën kohë në kujdesin për burimet dhe mjedisin, duke u përqëndruar në zhvillimn e qëndrueshëm në fushën e turizmit – me vëmendje të veçantë për një sistem të integruar të mbrojtjes së ujit me ndikim të ulët në mjedis. Duhet të fillojnë të zbatohen programe të veçanta në fushën e ruajtjes së biodiversitetit dhe habitateve të specieve në zonë. Duke pasur parasysh zakonet e kaluara të popullatës në zonë, dhe industrializimin e rajonit në të dyja anët e kufirit – veçanërisht në të kaluarën gjatë komunizmit, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edukimit mjedisor si një nga mjetet për një mbrojtje mjedisore afatgjatë dhe zhvillim të qëndrueshëm. Në terma afatgjatë kjo do të çojë në ndërtimin e bazave të forta për mbrojtjen mjedisore të qëndrueshme të burimeve natyrore.

Në nivel kombëtar, një ndikim i fortë duhet të ushtrohet mbi strategjitë e zhvillimit të turizmit për të mbajtur rajonin në krye të axhendave kombëtare të zhvillimit dhe promovimit.



Korniza ligjore për zonat e mbrojtura

CËSHTJA	Pikat e forta janë karakteristikat që ofrojnë avantazhe	Pikat e dobëta janë karakteristikat që çojnë në disavantazhe	Mundësitë janë shance për të përmirësuar situatën	Kërcënimet janë elementë të jashtëm që mund të shkaktojnë shqetësime
Korniza Institucionale dhe e Administrimit	- Dy nivele përgjegjësish - Trupë e veçantë përgjegjëse për liqenet	- Keq-koordinim midis shtetit qeverisjes lokale - Mungesë e kapaciteteve institucionale - Mbivendosje përgjegjësish	- Trajnim i përshtatshëm i të punësuarve në fushën e proceseve të vendim-marrjes - Zhvillimi i mekanizmave për koordinimin midis dy niveleve	- Ndryshime të shpeshta të personelit përgjegjës për këtë çështje - Mungesë e përhershme e kujtesës institucionale për rajonin
Politikat mjedisore	- Bashkëpunim i krijuar me vendet fqinje - Pak projekte të përbashkëta të realizuara - Kapacitet i respektueshëm ekspertësh	- Mungesë e dokumentacionit përkatës - Mungesë e përvojës së qeverisjes së mirë	- Përgatitja e dokumentit strategjik për zhvillimin integral të rajonit	- Shkatërrim i mëtejshëm i trashëgimisë natyrore të rajont
Korniza ligjore	- Kornizë ligjore relativisht e përshtatshme për sa i përket zonave të mbrojtura - Dokumenta ligjore të përshtatur me acquis (legjislacionin) e BE	- Mungesë e kapaciteteve implementuese - Mungesë e mbështetjes financiare të përshtatshme	- Trajnim për implementimin eficient të ligjeve dhe dokumenteve të tjera ligjore	- Mbetja e praktikës së ligjeve “të mira”pa një implementim të përshtatshëm
Administrimi i zonave të mbrojtura	- Zona të mbrojtura të përcaktuara mirë në rajon - Përvojë në mbrojtjen e tyre	- Mënyrë e ndryshme administrimi (publik dhe jo-qeveritar) - Mungesë e kapaciteteve shkencore - Bashkëpunim i dobët me institucionet shkencore	- Më shumë aktivitete kërkimore në zonat e mbrojtura - Përforcimi i masave mbrojtëse nëpërmjet aktiviteteve të integruara	- Humbja e statusit “zonë e mbrojtur” - Zhdukja e specieve të rralla në zonat e mbrojtura

KONKLUZIONE:

Për sa i përket kornizës ligjore për zonat e mbrojtura, në rajon është rritur ndërgjegjësimi i publikut dhe i institucioneve për rëndësinë e një qasjeje rajonale për zhvillimin e qëndrueshëm afatgjatë dhe menaxhimin e suksesshëm të zonave të mbrojtura në rajonin ndërkufitar. Deri tani ka pasur disa histori të suksesshme në fushën e iniciativave ndërkufitare dhe është krijuar një kapacitet i respektueshëm ekspertësh, i cili është në linjë me legjislacionin e BE-së. Zonat e mbrojtura janë të përcaktuara qartë dhe aktualisht ekzistojnë përvoja dhe kapacitetet për menaxhimin e zonave të mbrojtura.

Nga ana tjetër, implementimi dhe përforcimi i rregullave që kanë të bëjnë me menaxhimin e zonave të mbrojtura kanë ende nevojë për përmirësim. Ka mungesa të kapaciteteve dhe mekanizmave të implementimit dhe nuk ka shumë financime në këtë fushë. Ka gjithashtu raste të mbivendosjes së përgjegjësive dhe si pasojë keq-koordinim midis shtetit dhe qeverisjes vendore. Kjo çon në një paqëndrueshmëri të përforcimit ligjor dhe mungesë të iniciativave ndërkufitare midis institucioneve politike dhe shkencore.

Përpjekje të mëtejshme duhet të bëhen për të rritur kapacitetet (kryesisht ato njerëzore) e institucioneve të përforcimit të ligjit në rajon dhe për të lehtësuar procesin e zhvillimit të mekanizmave ndërkufitarë për koordinimin e aktiviteteve në fushën e menaxhimit të zonave të mbrojtura. Duhet të merret në konsideratë një qasje strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm të integruar në rajon dhe për ruajtjen e integruar të zonave të mbrotjura. Duhet të lindë një proces planifikues strategjik me pjesëmarrje të plotë të të gjithë palëve të interesuara nga të dyja anët e kufirit, me një fokus të veçantë mbi punonjësit shkencorë.

Nëse nuk ndërmerren masa urgjente, skenari më i keq është zhdukja e specieve të rralla në zonat e mbrojtura, të cilat kanë të vlerë të madhe kombëtare dhe botërore dhe kjo mund të çojë në humbjen e statusit Zonë e Mbrotjur që mund të ketë pasoja ekonomike dhe sociale negative në të gjithë rajonin ndërkufitar.



Situata sociale dhe ekonomike

ÇËSHTJA	Pikat e forta janë karakteristikat që ofrojnë avantazhe	Pikat e dobëta janë karakteristikat që çojnë në disavantazhe	Mundësitë janë shance për të përmirësuar situatën	Kërcënimet janë elementë të jashtëm që mund të shkaktojnë shqetësime
Popullsia dhe migrimi	- Popullatë heterogjene nga pikëpamja etnike dhe fetare - Traditë e gjatë në bashkëjetesë	- Imigrimi i shkaktuar nga shkaqe ekonomike (papunësia, standarti i ulët i jetesës) - Tensione ndëretnike - Migrimi nga zonat rurale në ato urbane	- Masa ekonomike dhe sociale për të motivuar popullatën rurale që të qëndrojë - Rritja e mirëkuptimit reciprok	- Stanjacion i vazhdueshëm i rritjes ekonomike - Konflikte sociale dhe të tjera - Degradim i zonave rurale
Të ardhurat dhe punësimi	- Përqindje e lartë e popullatës aktive në rajon - Forcë pune e kualifikuar e disponueshme (por e kufizuar)	- Papunësi e lartë - Pabarazi në punësim midis zonave rurale dhe urbane - Strukturë arsimore e papërshtatshme e personave të papunë	- Investime direkte nga entitetet e huaja dhe të vendit - Motivim i emigrantëve që të investojnë	- Rritja e papunësisë - Ulja e të ardhurave të familjeve
Struktura ekonomike	- Strukturë ekonomike fleksibile e bazuar te firmat e vogla	- Mungesë e kompanive të mesme e të mëdha që mund të shërbejnë si bazë për rritjen ekonomike	- Promovimi i të ashtuquajturave teknologji "të pastra" - Më shumë investime në turizëm dhe restoracion	- Zhvillim i kapaciteteve industriale që mund të ndikojnë në mjedis
Përdorimi i tokës dhe bujqësia	- Prodhim i frutave - Organizim familjar i aktiviteteve bujqësore në ferma të vogla	- Rreth 60% e tokës bujqësore nuk përdoret - Mungojnë kompanitë e përpunimit ushqimor - Mungesë e sistemeve efiçente të vaditjes	- Hapje e ndërmarrjeve përpunuese dhe kapaciteteve frigoriferike - Trajnim i fermerëve dhe të të papunëve - Implementim i GAP	- Reduktimi i mëtejshëm i prodhimit bujqësor

ÇËSHTJA	Pikat e forta janë karakteristikat që ofrojnë avantazhe	Pikat e dobëta janë karakteristikat që çojnë në disavantazhe	Mundësitë janë shance për të përmirësuar situatën	Kërcënimet janë elementë të jashtëm që mund të shkaktojnë shqetësime
Blegtoria	- Kullota të bollshme - Diversitet i racave dhe llojeve të kafshëve blegtorale	- Sektor blegtoral i dobët - Mungesë e strukturave të përpunimit bulmetor - Ushqimi i gjësë së gjallë nuk mbulohet nga prodhimi vetjak	- Trajnim i blegtorëve - Investime në përpunimin e qumështit dhe mishit	- Stanjacion i prodhimit blegtoral - Degradim i mëtejshëm i tokës për foragjere
Bizneset	- Sektorë të ndryshëm biznesi - Zonë ekonomike e hapur në Strugë	- Praktika të sektorit gri - Paqëndrueshmëri politike - Infrastrukturë e dobët	- Mbështetje e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme - Trajnim i sipërmarrësve	- Nivel i ulët i aktiviteteve sipërmarrëse
Peshkimi	- Peshk i pandotur - Specie të shijshme dhe të shtrenjta peshqish	- Kontribut i vogël në ekonominë kombëtare (0.1%) - Mungesë e kujdesit të organizuar për financimin e peshkimit	- Masa sistematike për peshkimin e qëndrueshëm të specieve endemike - Investime në industrinë e përpunimit dhe ruajtjes së peshkut	- Zhdukje e specieve endemike, veçanërisht troftës së Ohrit
Turizmi dhe infrastruktura	- Lokalizim gjeo-strategjik i shkëqyer - Klimë kontinentale e moderuar dhe mesdhetare - Fond i jashtëzakonshëm i florës dhe faunës - Zona me mjedis natyror të ruajtur dhe ushqim të shëndetshëm - Trashëgimi historike dhe kulturore e pasur - Kushte të shkëlqyera për zhvillimin e sporteve dimërore - Resorte turistike dhe kafene në plazhe - Traditë e shprehur në fushën e mikpritjes dhe folklorit	- Infrastrukturë transporti e dobët - Ofertë turistike e dobët në Prespë	- Investime në zonën e Prespës në turizëm dhe restoracion - Trajnim i popullsisë lokale - Aktivitete promovuese për zhvillimin e turizmit në rajon - Përmirësim i infrastrukturës së transportit në rajon, veçanërisht asaj hekurudhore	- Stanjacion i turizmit në Prespë - Presion antropogjen i lartë në liqene - Teknologji “të pista” në sektorin industrial

ÇËSHTJA	Pikat e forta janë karakteristikat që ofrojnë avantazhe	Pikat e dobëta janë karakteristikat që çojnë në disavantazhe	Mundësitë janë shance për të përmirësuar situatën	Kërcënimet janë elementë të jashtëm që mund të shkaktojnë shqetësime
Përdorimi i energjisë	- Numër i konsiderueshëm ditësh me diell - Disponueshmëri e burimeve të energjisë së rinovueshme - Kapacitete të disponueshme kërkimore për rritjen sistematike të burimeve energjitike jo-tradicionale (biogaz, energji eolike, etj.)	- Varësi nga importi në sektorin energjitik - Potencial hidroenergjitik i papërdorur	- Investime në përdorimin e energjisë së rinovueshme - Trajnim i popullsisë lokale - Përfitime për përdoruesit e burimeve të energjisë së rinovueshme	- Import me kosto të lartë i energjisë
Edukimi	- Fonde të disponueshme për edukimin mjedisor - Sektori i OJQ-ve që merren me çështjet mjedisore relativisht i zhvilluar - Prani e institucioneve të përshtatshme shkencore dhe arsimore të përfshira në edukimin mjedisor	- Mungojnë kurrikula lokale për edukimin mjedisor në arsimin publik - Nuk ekzistojnë strategji për edukimin mjedisor në nivel kombëtar dhe rajonal - Nuk janë të përcaktuara grupet e synuara të edukimit mjedisor - Nuk ekzistojnë aktivitete në disa fusha të edukimit mjedisor (bujqësia e qëndrueshme, energjia e rinovueshme, ekoturizmi)	- Krijimi i kurrikulave mjedisore lokale - Përgatitje e programit për edukimin mjedisor në rajon - Zhvillim i mjeteve trajnuese specifike për llojet specifike të edukimit mjedisor	- Shkatërrim i mëtejshëm i mjedisit - Margjinalizim i mëtejshëm i çështjeve të rëndësishme si prodhimi i qëndrueshëm i ushqimit, ekoturizmi, energjia e rinoveshme

ЗАКЛУЧОЦИ:

Për të bërë një analizë ekonomike dhe sociale duhen marrë në konsideratë një sërë fushash në mënyrë që të nxirren konkluzione cilësore. Kjo analizë fokusohet në këto fusha: popullsia dhe migrimi, të ardhurat dhe punësimi; struktura ekonomike; përdorimi i tokës dhe bujqësia; blegtoria; bizneset; peshkimi; turizmi dhe infrastruktura; përdorimi i energjisë dhe edukimi mjedisor.

Nga perspektiva sociale dhe ekonomike, rajoni karakterizohet nga popullsi heterogjene nga pikëpamja etnike dhe fetare, me vlera shumë të forta kulturore dhe tradicionale. Një pjesë e mirë e popullsisë është aktive dhe ka forcë pune të kualifikuar, por ka një nivel të lartë të papunësisë dhe burimeve njerëzore të papërdorura. Kjo është një nga arsyet kryesore të migrimit të popullsisë, veçanërisht nga zonat rurale në kryeqytete ose jashtë vendit. Struktura e biznesit mbizotërohet nga bizneset e vogla dhe të mesme, mungojnë investimet e huaja dhe kompanitë e mëdha të mund të shërbejnë si motorr për rritjen ekonomike. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të "teknologjive të pastra" dhe investimeve në turizëm si një fushat ekonomike më premtuese në të dyja anët e kufirit. Kur bëhet promovimi i biznesit duhet të jenë të qarta llojet e biznesit që duhet të zhvillohen në rajon, duhet të kihet parasysh zhvillimi i qëndrueshëm dhe ndikimi industrisë në mjedis dhe vlerat kulturore e natyrore.

Në fushën e bujqësisë, e cila është tradicionalisht aktiviteti kryesor fitimprurës në rajon, ekzistojnë fermat e vogla familjare të cilat nuk mund të jenë konkurruese në tregun bujqësor. Ka sipërfaqe të mëdha tokash të cilat nuk përdoren dhe nuk ka një numër të mjaftueshëm kompanish përpunuese të cilat në të njëjtën kohë mund të stimulojnë popullatën për të përdorur tokën. Situata aktuale tregon që prodhimi bujqësor në rajon ka një tendencë në rënie e cila në terma afatgjatë ndikon mbi të ardhurat e familjeve dhe në zhvillimin e rajonit, dhe në të njëjtën kohë rrit migrimin e popullsisë. Situata është e ngjashme në sektorin e blegtorisë. Është e nevojshme një strategji rajonale ose kombëtare në mënyrë që të fillojë një proces përforcimi i këtyre dy fushave të rëndësishme. Situata është disi më ndryshe në sektorin e peshkimit, i cili karakterizohet nga peshk i pandotur i cilësisë së mirë, por edhe këtu mungojnë iniciativat e organizuara për mbarështimin e peshkut dhe "kujdes për fondin e peshqve" specifik, dhe mungon industria e përpunimit të peshkut në rajon. Nga ana tjetër duhet të tregohet kujdes i veçantë për ruajtjen nga peshkimi i tepruar në mënyrë që të mbahet një popullatë e qëndrueshme peshqish në rajon.

Turizmi është një nga industritë mbizotëruese në rajon dhe shumë familje përfitojnë të ardhurat kryesore nga turizmi. Rajoni ndodhet në një

pozicion gjeo-strategjik shumë të mirë me kushte të këndshme klimatike, ka një fond të jashtëzakonshëm të faunës dhe florës, mjedis natyror të ruajtur shumë mirë dhe ushqim të shëndetshëm. Përveç këtyre, rajoni ka një trashëgimi kulturore dhe historike të pasur dhe një traditë të fortë mikpritjeje dhe folklori. Një vëmendje e veçantë nevojitet në promovimin e turizmit të organizuar dhe investimeve në infrastrukturën turistike, në mungesën e shërbimeve turistike dytësore dhe në strukturat e turizmit të cilësisë së lartë.

Duke u bazuar në faktet e sipërpërmendura dhe situatën aktuale në rajon, lind nevoja për programe edukative të gjera që duhet të kenë si objektiv popullsinë lokale, bizneset, organizatat e shoqërisë civile dhe gjithashtu qeverisjen lokale. Edukimi është veçanërisht i nevojshëm për të parandaluar aktivitetet ekonomike private të mundshme të cilat janë shumë të famshme dhe tërheqëse nga pikëpamja ekonomike, por nga ana tjetër mund të kenë ndikime negative të mëdha mbi mjedis dhe në shëndetin e njerëzve. Kufiri midis rritjes ekonomike dhe mbrojtjes së mjedisit është shumë i ngushtë, dhe vetëm personat me një edukim të mirë mund të kuptojnë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm.

Vlerësimi i situatës mjedisore

ÇËSHTJA	Pikat e forta janë karakteristikat që ofrojnë avantazhe	Pikat e dobëta janë karakteristikat që çojnë në disavantazhe	Mundësitë janë shance për të përmirësuar situatën	Kërcënimet janë elementë të jashtëm që mund të shkaktojnë shqetësime
Ndërhyrjet në basenin e liqeneve dhe ndryshimet në regjimin e ujit	- Bilanc hidrik relativisht i mirë në Liqenin e Ohrit - Drenim i një sipërfaqeje bujqësore të gjerë rreth liqenit	- Humbje e përhershme e ujit në Liqenin e Prespës - Saturim i bregut të Liqenit të Ohrit me sediment nga lumi Sateska - Bimësia e bregut në hyrje të Lumit Sateska është zhdukur	- Pastrimi i shtratit të lumit Sateska	- Shkatërrim i mëtejshëm i jetës së egër në Liqenin e Prespës si pasojë e humbjes përhershme të ujit - Ndryshim i bregut të Liqenit të Ohrit në afërsi të Lumit Sateska
Burimet ndotëse të ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësorë	- Cilësia e ujit në Liqenet e Ohrit dhe Prespës është ende relativisht e pranueshme	- Përdorimi i "kimikateve" në prodhimin agro-ushqimor - Ulje e strukturave të trajtimit të ujërave industriale - Sisteme të pastrimit të ujërave të zeza jo të plota rreth liqenit - Lumenj të mëdhenj shkarkohen në liqen, veçanërisht Sateska, Velgovska dhe Koselska	- Përfundim i sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza në të dyja anët e liqenit - Instalim i strukturave të trajtimit të mbetjeve ujore si kusht për objektet e reja industriale - Trajnim për përdorimin e pesticideve që nuk dëmtojnë mjedisin	- Akumulim i përbërjeve toksike në liqene (metale të rënda, pesticide, etj.) - Kontaminim me baktere dhe viruse sëmundje-shkaktues
Eutrifikimi i liqenit	- Liqeni i Ohrit është ende oligotrofik	- I fertilizuar nga nutrientët, detergjentët, mbetjet njerëzore dhe të kafshëve	- Kufizim i të gjithë ndotësve të mundshëm që shkaktojnë eutrifikim të liqenit	- Veprimet e njerëzve po përshpejtojnë me ritme të mëdha eutrifikimin

ÇËSHTJA	Pikat e forta janë karakteristikat që ofrojnë avantazhe	Pikat e dobëta janë karakteristikat që çojnë në disavantazhe	Mundësitë janë shance për të përmirësuar situatën	Kërcënimet janë elementë të jashtëm që mund të shkaktojnë shqetësime
Menaxhimi i mbetjeve të ngurta	- Vend-depozitime të mbetjeve të liçensuara nga BE në rajon	- Më shumë se 50 vend-depozitime jo të lejuara të mbetjeve - Mungesë e strukturave të depozitimit të mbetjeve - Kapacitete ricikluese të pakta - Mungesë e infrastrukturës së përshtatshme	- Përmirësim i infrastrukturës së mbetjeve të ngurta - Trajnim i administratës publike të përfshirë në trajtimin e mbetjeve	- Ndotje e ujit nëntokësor që shërben si burim i ujit të pijshëm
Shpyllëzimet	- Bimësi pyjore e shumëllojshme	- Shfrytëzim i tepruar i lëndëve të para në industrinë e drurit	- Aksione masive për rinovimin e pyjeve në rajon - Edukim mjedisor që lidhet me rëndësinë e "mushkërisë së gjelbër" në Planet	- Zhdukje e disa specieve të pemëve - Erozion i tokës si pasojë e shpyllëzimit
Praktikat e përdorimit të tokës	- Tokë e disponueshme për qëllime të ndryshme	- Reduktim i sipërfaqes bujqësore - Reduktim i pyjeve dhe kullotave	- Masa për të përmirësuar praktikat e përdorimit të tokës - Përcaktim i përdorimit të tokës për të vlerësuar madhësinë e këtij problemi	- Përdorim i papërshtatshëm i tokës - Urbanizim i papërshtatshëm i rajonit

ÇËSHTJA	Pikat e forta janë karakteristikat që ofrojnë avantazhe	Pikat e dobëta janë karakteristikat që çojnë në disavantazhe	Mundësitë janë shance për të përmirësuar situatën	Kërcënimet janë elementë të jashtëm që mund të shkaktojnë shqetësime
Praktikat e peshkimit dhe gjuetisë	- Kufizim i peshkimit të troftës së Ohrit në anën maqedonase - Masa aktive për të rregulluar aktivitetet e gjuetisë	- Mungesë e qasjeve sistematike në mbrojtjen e peshqve endemikë në liqene - Jeta e egër në zonat e gjuetisë është në rrezik - Futje e specieve jo-indigjene në liqene - Keqpërdorim i aktiviteteve gjuetare	- Rinovim i popullatës së troftës së Ohrit dhe specieve të tjera të rrezikuara të peshqve - Trajnim i peshkatarëve për peshkim të qëndrueshëm	- Popullatat e troftës janë nën një stres të rëndë dhe janë të kërcënuara gjithashtu popullatat e gjuhëzave dhe krapit
Menaxhimi i burimeve natyrore	- Përvojë e bazuar në projekte - Investime të mëparshme në këtë lloj menaxhimi nëpërmjet projekteve	- Menaxhim i bazuar në projekte në vend që të jetë i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm	- Zhvillimi i strategjisë për menaxhimin e burimeve natyrore në rajon	- Shkatërrim i burimeve natyrore në rajon
Menaxhimi i zonave të mbrojtura	- Entitete publike të krijuara që menaxhojnë parqet kombëtare - Partneritet OJQ-institucione publike	- Mungesë e kapaciteteve për menaxhim të suksesshëm të zonave të mbrojtura	- Implementim i politikave të qeverisjes së mirë në menaxhimin e zonave të mbrojtura - Trajnim jo-zyrtar i punonjësve	- Keqpërdorim i zonave të mbrotjura për aktivitete të ndaluara (gjueti e paautorizuara, shkatërrim i biodiversitetit, rrezikim i specieve të rralla, etj.)

KONKLUZIONE:

Mund të themi që situata mjedisore në rajon është ende e mirë me disa pika të nxehta të cilat nuk paraqesin rrezik rajonal. Cilësia e ujit në Liqenet e Ohrit dhe Prespës është ende e mirë. Liqeni i Ohrit është ende eutrofik dhe ka një shumëllojshmëri të bimësisë pyjore. Pavarësisht se situata është e mirë në përgjithësi, ka disa tendenca që mund të shkaktojnë probleme të rënda mjedisore nëse nuk menaxhohen siç duhet. Shqetësimet kryesore janë humbja e vazhdueshme e ujit të Liqenit të Prepës, saturimi i bregut të Liqenit të Ohrit me sediment nga lumi Sateska, tendenca për përdorim të tepruar të pesticideve në bujqësi dhe mungesa e strukturave të trajtimit të mbetjeve ujore industriale. Sistemi i ujërave të zeza nuk është ende i plotë dhe janë mbi 50 pirgje ilegale mbetjesh rreth liqenit. Nuk ka një qasje sistematike në mbrojtjen e specieve endemike në liqen, veçanërisht të peshqve të Liqenit të Ohrit, ka shumë raste të futjes së specieve jo-indigjene dhe ekziston tendenca e keq-përdorimit të aktiviteve të gjuetisë dhe gjuetisë së tepruar.

Deri tani ka pasur disa iniciativa ndëkufitare në menaxhimin e përbashkët në disa nga zonat e mbrojtura ose burimet e përbashkëta, por ka ende shumë hapësirë për këto lloj aktivitetesh menaxhimi ndërkufitar sistematik. Është e nevojshme ekzistenca e një strategjie të përbashkët për menaxhimin e burimve dhe zonave të mbrojtura dhe veçanërisht për sinkronizimin e veprimeve të mbrojtjes së specieve në të dy anët e kufirit. Edukimi është i një rëndësie thelbësore dhe mbështetja e mëtejshme e oganizateve të shoqërisë civile në fushën e edukimit jo-publik të popullatës dhe punonjësve në institucionet që menaxhojnë burimet natyrore në rajon.

Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojës për edukim mjedisor

ÇËSHTJA	Pikat e forta janë karakteristikat që ofrojnë avantazhe	Pikat e dobëta janë karakteristika që çojnë në disavantazhe	Mundësitë janë shance për të përmirësuar situatën	Kërcënimet janë elementë të jashtëm që mund të shkaktojnë shqetësime
Turizmi dhe aktivitetet e kohës së lirë	- Rrjetet institucionale (insitucione profesionale dhe akademike)	- Mungesë e kurrikulave bashkëkohore që merren me zhvillimin e turizmit të bazuar në respektin e mjedisit	- Programe të veçanta për edukimin mjedisor zyrtar dhe jozyrtar në sektorin turistik	- Ndikimi negativ i turizmit mbi mjedisin e rajonit
Prodhimi dhe përpunimi i ushqimit	- Sektor i larmishëm i OJQ-ve	- Mungesë e aktiviteteve për trajnimin e fermerëve rreth bujqësisë organike dhe ushqimit të shëndetshëm	- Zhvillimin i programeve për ushqimin e shëndetshëm dhe bujqësinë e qëndrueshme në edukimin bashkëkohor - Trajnim i fermerëve dhe punonjësve reth kompanive të përpunimit ushqimor	- Prodhim ushqimor në rajon me përdorim të lartë të kimikateve - Konsum i ushqimit jo të shëndetshëm
Burimet e energjisë	- Rritja e ndërgjegjësimit publik për energjinë e pastër	- Mungesa e njohurive dhe ndërgjegësimit rreth burimeve të energjisë së rinovueshme në rajon	- Trajnim i qytetarëve dhe pronarëve të objekteve turistike mbi burimet e energjisë së rinovueshme	- Energji e shtrenjtë dhe mungesë e saj
Industria	- Kapacitete industriale fleksibile	- Në kompanitë industriale aktive janë të pranishme energjitë “e pista”	- Transferim efiçent i teknologjive të pastra në industrinë rajonale - Masa parandaluese për mbrojtjen e mjedisit gjatë fazës përgatitore në kompanitë e reja	- Ndikim i mëtejshëm në mjedis i burimeve industriale të ndotjes

ÇËSHTJA	Pikat e forta janë karakteristikat që ofrojnë avantazhe	Pikat e dobëta janë karakteristika që çojnë në disavantazhe	Mundësitë janë shance për të përmirësuar situatën	Kërcënimet janë elementë të jashtëm që mund të shkaktojnë shqetësime
Aktivitetet terciare	- Mbështetje e bizneseve të vogla	- Kapacitete të kufizuara të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	- Kurse trajnuese për prodhimin e punimeve të bëra me dorë nga materiale natyrore	- Papunësi e lartë
Trafiku dhe infrastruktura e transportit		- Po rritet numri i automjeteve që përdorin gaz natyror	- Rritja e ndërgjegjësimit për një transport hekurudhor që nuk ndot mjedisin	- Ndotje e mëtejshme e mjedisit nga trafiku
Zhvillimi ekonomik i përgjithshëm		- Zhvillimi ekonomik nuk është në përputhje me mbrojtjen mjedisore në rajon	- Programe trajnimi për simbiozën midis ekonomisë dhe ekologjisë	- Presion i lartë nga sektori ekonomik mbi mjedis në rajon
Rritja e ndërgjegjësimit publik	- Rrjete të mira edukuese - Sektori i OJQ-ve i zhvilluar mirë	- Iniciativat për rritjen e ndërgjegjësimit publik nëpërmjet organizatave jo-qeveritare	- Fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik	- Shkatërrimi i mjedisit nga burime të ndryshme ndotjeje dhe presioni

KONKLUZIONE:

Kapacitetet në rajonin ndërkufitar janë në përforcim konstant, por ka ende shumë nevojë veçanërisht për aktivitete jo-zyrtar të edukimit mjedisor. Ekziston një rrjet i mirë institucionesh dhe profesionistësh në rajon, sektori i shoqërisë civile i cili është i larmishëm, luan një rol të rëndësishëm në edukimin mjedisor dhe ka disa iniciativa të mira ndërkufitare për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e energjisë së pastër. Kjo gjendje duhet të përdoret për aktivitete mjedisore të vazhdueshme dhe sistematike dhe ekziston nevoja për krijimin e një Qendre të Edukimit Mjedisor, që të ketë si fokus të veçantë zhvillimin e qëndrueshëm dhe masat për zhvillimin e qëndrueshëm që duhet të merren në konsideratë në procesin e industrializimit të mëtejshëm të rajonit.

Ekziston nevoja për edukim të mëtejshëm të gjerë të fermerëve në fushat e përdorimit të pesticideve dhe bujqësisë organike dhe prodhimit të ushqimit të mëtejshëm. Nevojitet edukimi i biznesit mbi energjinë e pastër, energjinë e rinovueshme dhe kursimin e energjisë si parime të zhvillimit të qëndrueshëm. Një vëmendje e veçantë nevojitet në fushën e përputhshmërisë së zhvillimit të mjedisit me mbrojtjen mjedisore dhe që mbrojtja e mjedisit nuk është një faktor kufizues për rritjen e biznesit.



Rekomandime

1. Në nivel kombëtar, duhet të ushtrohet një ndikim i fortë mbi strategjitë e zhvillimit të turizmit në mënyrë që të rajoni të jetë në krye të axhendës kombëtare për zhvillim dhe promovim.
2. Iniciativat e përbashkëta duhet të përqëndrohen në përmirësimin e infrastrukturës dhe shndërrimin e rajonit në një zonë me akses të lehtë, por në të njëjtën kohë të kujdesen për burimet natyrore dhe mjedisin, duke u përqëndruar në zhvillimin e qëndrueshëm në fushën e turizmit – me vëmendje të veçantë në një sistem të integruar të mbrojtjes së ujit me ndikim të ujët në mjedis.
3. Përpjekje të mëtejshme duhet të bëhen për të rritur kapacitetet (kryesisht ato njerëzore) të institucioneve të përforcimit të ligjit në rajon dhe për të lehtësuar procesin e zhvillimit të mekanizmave ndërkufitare për koordinimin e aktiviteteve në fushën e menaxhimit të zonave të mbrojtura
4. Duhet të merret në konsideratë një qasje e integruar për zhvillimin e qëndrueshëm të plotë të rajonit dhe ruajtjen e integruar e zonave të mbrojtura. Duhet të zhvillohet një proces planifikues strategjik me pjesëmarrje të lartë ku të përfshihen të gjitha palët e interesuara nga të dyja anët e kufirit, me vëmendje të veçantë për punonjësit shkencorë.
5. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të "teknologjive të pastra" dhe investimeve në turizëm si një nga fushat ekonomike më premtuese në të dyja anët e kufirit. Gjatë zhvillimit të bizneseve duhet të jenë të qarta llojet e bizneseve që duhet të zhvillohen në rajon, duke pasur parasysh zhvillimin e qëndrueshëm dhe ndikimin e industrisë mbi mjedisin dhe vlerat kulturore dhe natyrore.
6. Janë të nevojshme programe edukuese të gjera që duhet të kenë si objektiv popullsinë lokale, bizneset, organizatat e shoqërisë civile, si dhe organet e qeverisjes lokale. Edukimi është veçanërisht i nevojshëm për të parandaluar aktivitetet ekonomike tërheqëse nga pikëpamja ekonomike, por nga ana tjetër mund të kenë efekte negative të mëdha mbi mjedisin dhe shëndetin e popullatës.
7. Janë të nevojshme strategji të përbashkëta për menaxhimin e burimeve dhe zonave të mbrojtura dhe veçanërisht sinkronizimin e veprimeve të mbrojtjes së specieve në të dyja anët e kufirit.
8. Edukimi ka një rëndësi të veçantë dhe nevojitet një mbështetje e mëtejshme e organizatave të shoqërisë civile në fushën e edukimit jo-zyrtar të popullatës dhe punonjësve të institucioneve që menaxhojnë burimet natyrore në rajon.



9. Për aktivitetet e edukimit mjedisor të vazhdueshëm dhe sistematik duhet të përdoren burimet lokale dhe nevojitet krijimi i një Qendre të Edukimit Mjedisor rajonale që të përqëndrohet në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në masat që duhen marrë në konsideratë për zhvillimin e qëndrueshëm në procesin e industrializimit të mëtejshëm të rajonit.
10. Ekziston nevoja për edukim të gjerë të mëtejshëm të fermerëve në fushat e përdorimit të pesticideve de bujqësisë organike dhe prodhimin e ushqimit të shëndetshëm.
11. Ekziston nevoja për edukim të bizneseve mbi teknologjitë e pastra, energjinë e rinovueshme dhe kursimin e energjisë, si parime të zhvillimit të qëndrueshëm

Ky dokument u përgatit nga:

KOCKA Training Institute,

Në kuadër të projektit:

“Përforcimi i Capaciteteve Edukuese dhe Trajnuese për Ruajtjen e Burimeve Natyrore në Basenet e Ohrit-Prespës”

Kontratë Numër: 2012/288-302

Mars 2013



Financuar nga Bashkimi Europian